

VENDIM
Nr. 42, datë 6.9.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN
“PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SHOQËRIVE TË
KURSIM-KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË TYRE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 60, pika 1, dhe të nenit 69, pika 6, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 104, datë 5.10.2016, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

i. Në nenin 5, pika 8/1 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“8/1. SHKK-ja, për çdo pagesë dhe/ose shtesë të kapitalit nga çdo anëtar dhe/ose fondet e donatorëve nën vlerën 100,000 lekë, përveç kontributeve që shërbejnë si kusht për anëtarësimin në SHKK, siguron dhe mban në dosje të veçanta dokumentacionin e parashikuar në shkronjën “f”, nënpika “iii” ose në shkronjën “g”, nënpika “iii” të pikës 2, të nenit 6 të kësaj rregulloreje.”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko